



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 77, Datë 12.03.2026

MBI

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 302,
DATË 17.11.2025 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPITALLA SOLAR” SH.P.K.
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 404/1 prot., datë 09.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të ERE-s “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 302, datë 17.11.2025, ka licencuar shoqërinë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 90 MW, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, Qarku Durrës, për një afat 30 vjeçar.
- Në pikën 2 të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: “Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e transmetimit”.
- Gjithashtu në pikën 5 të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 302/2025 me shkresën nr. 2403/15 prot., datë 21.11.2025, duke i sjellë në vëmendje dhe plotësimin e kushteve të këtij vendimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 404 prot., datë 28.01.2026, shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të parkut fotovoltaiik Spitalla Solar”, të nënshkruar më 19.01.2026, ndërmjet OST sh.a. dhe shoqërisë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k..

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Me depozitim nga shoqëria të “Marrëveshjes për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të parkut fotovoltaiik Spitalla Solar” të nënshkruar me OST sh.a., rezulton se është plotësuar kushti i vendosur në pikën 2 të vendimit të ERE-s nr. 302/2015, ndaj kjo pikë e vendimit vlerësohet të shfuqizohet.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2 të vendimit nr. 302/2025, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 5 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, si vijon:
 - a) Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, shfuqizohet.
 - b) Pika 5 e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, ndryshon dhe bëhet: *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI